



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVA
REPUBLIKA KOSOVA
KUVENDI I KOMUNËS –SUHAREKË
THE MUNICIPALITY SUHAREKË
SKUPSTINA OPSTINE SUVA REKA



Duke u bazuar në nenin 7, 12 dhe 17 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr-03/L-040, nenin 3 dhe 29 të Statutit të Komunës së Suharekës 01-Nr-8336 të datës 04.11.2008, Kuvendi i Komunës në Suharekë në mbledhjen e mbajtur me datën _____ mori këtë:

PROJEKT- V E N D I M

Neni 1.

Me këtë vendim aprovohet flamuri i Komunës së Suharekës. Flamur i Komunës përfaqëson karakterin gjeografik, historik, kulturor, ekonomik dhe tradicional. Si i tillë ai paraqet jetën, paqen, lirinë, demokracinë dhe energjinë pozitive që ka komuna jonë.

Neni 2.

Flamuri i Komunës së Suharekës e ka sfondin e kaltër, ndërsa në mes qëndron figura e diellit me 42 rreze, me ngjyrë të verdhë dhe gjethi i hardhisë së rrushit që ka dy ngjyra të shkrira në njëra tjetrën: të kuqen dhe të zezën, secila rreze simbolizon nga një vendbanim të komunës tonë. Flamuri standard ka këtë gjatësi 1.5 m dhe gjerësi 1m. Format mund të ndryshoj por gjithnjë duke u rritur ose zvogëluar në mënyrë proporcionale.

Neni 3.

Ky vendim hyn në fuqi ditën e miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Suharekës.

KUVENDI KOMUNAL –SUHAREKË

01-Nr _____
Më datë _____

Kryesuesi i Kuvendit

Rexhep Kuçi